

## **DETYRIMET E AZHBR**

### **NDAJ SUBJEKTEVE TË INTERESUAR PËR BASHKËPUNIM ME AZHBR PËR TË QENË PJESË AKTIVE NË REALIZIMIN E INVESTIMEVE TË PARASHIKUARA NË PROGRAMIN IPARD**

- Të publikojë në web “FTESË” për regjistrimin në Sistemin elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB) së bashku me dokumentet e nevojshme që i duhen subjekteve për Regjistrim.
- Të vlerësojë dokumentet e subjekteve për regjistrim në Sistemin elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB) dhe të njoftojë subjektet për vendimin e marrë.
- Të vlerësojë e të regjistrojë çmimet/ofertat e dërguar nga subjektet në Sistemin elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB) dhe të njoftojë subjektet në rast se informacioni nuk regjistrohet duke argumentuar nëse informacioni ka nevojë për plotësime/shpjegime ose kur informacioni është i parregullt.
- Të pajisë subjektet “e paregjistruara”, të cilët kanë dërguar informacionin me e-mail, me kredenciale “emri përdoruesit” dhe “fjalëkalim” për aksesimin e sistemit elektronik të PRDB.
- Të përcaktojë periudhën e mbledhjes së informacionit nga subjektet dhe përditësimin e Sistemit elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB).
- Sipas rastit, të dërgojë me e-mail “Kërkesë për ofertë” për zëra/asete për të cilat nuk ka të dhëna të mjaftueshme në Sistemin elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB).
- Të ruajë konfidencialitetin e informacionit financiar dhe administrativ të dërguar nga subjektet.
- Të jap shpjegime subjekteve lidhur me procedurat apo specifikimet teknike për zëra/asete të veçanta sipas kërkesës së tyre të dërguara me e-mail. Shpjegimet esenciale do të publikohen në webin e AZHBR-së.
- Të ofrojë suport teknik për përdoruesit e Sistemit elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB) nëpërmjet numrit jeshil 0800 83 83
- Nëse iniciohet një pezullim me ndonjë nga subjektet e regjistruara, i gjithë informacioni i ofruar nga subjekti do të pezullohet në sistemin e PRDB.

- Të reklamojë në webin [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al) emrat e subjekteve dhe fushat e aktivitetit të tyre për të cilat kanë ofruar informacion (çmime/oferta) të regjistruara në Sistemin elektronik të Bazës së të dhënave për Çmimet e Referencës (PRDB).